

Paketimet me materiale të lehta

Paketimet me materiale të lehta nënkuptojnë të gjitha paketimet prej plastike, metali, alumini, stiropori, materiale të përziera (letër, plastikë, alumin). Të gjitha këto, të pastruara, pa mbetje të tjera, duhet të depozitohen në qeset e verdha dhe më pas, në koshat e verdhë.

Rregull i përgjithshëm: Të gjitha paketimet që nuk janë prej qelqi ose prej letre, klasifikohen në grupin e «verdhë».

Paketimet e margarinës, kremit, pudingut dhe të kosit

Paketimet e frutave dhe perimeve, apo të ushqimeve të gatshme për mikrovalë

Paketimet e patatinave dhe të kikirikave

Paketimet prej kartoni të lengjeve (TetraPak)

Paketimet e konservave dhe të pijeve, paketimet boshe me mekanizëm sprucimi

Paketime prej alumini (p.sh. paketime kafeje në vakuum)

Shishet e zbutësve, etj.

Qeset plastike dhe mbulesat plastike të paketimeve

Nuk kanë arsye të jenë në qeset/koshat e verdhë, p.sh.: paketimet shumë të ndotura, mbeturinat e ndërtimit dhe të rinovimeve, mjetet e regjistrimeve zanore, letrat e paketimit, rrjetat prej teli dhe kashte, litarët, ngjitëset (p.sh. ngjitëset që përdoren për kutitë prej kartoni), lodrat e fëmijëve, këpucët, tekstilet, mbetjet e tapeteve, plehrat e rënda, qeset e fshesës elektrike, medikamentet, sprucot, tubat, bateritë, të gjitha tenxheret dhe pajisjet e kuzhinës, ose materiale të përdorshme të të gjitha llojeve.

Edhe lëkurat e sallameve, serviset plastike të ngrënies me një përdorim, buqetat me lule, ndriçuesit e çajit apo të varrezave paketimet e CD-ve dhe DVD-ve, videokasetat. kutitë dhe valixhet e veglave të punës, klasifikohen pa përjashtim në koshat e mbeturinave të tjera.